

LIGJ
Nr. 4/2023

**PËR MIRATIMIN E REZOLUTAVE NR. 663 “RRITJA E PËRGJITHSHME
E KAPITALIT GCI” DHE NR. 664 “RRITJA SELEKTIVE E KAPITALIT SCI” TË
VITIT 2018 TË KËSHILLIT TË GUVERNATORËVE TË BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Miratohen rezolutat nr. 663 “Rritja e përgjithshme e kapitalit (GCI)” dhe nr. 664 “Rritja selektive e kapitalit (SCI)” të vitit 2018 të Këshillit të Guvernatorëve të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

Neni 2

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rregullat dhe autoritetin kompetent për realizimin e rritjes së përgjithshme të kapitalit të Republikës së Shqipërisë në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 26.1.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 23 datë 15.2.2023, të presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

Njoftim Publik i Autorizuar



BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

BORDI I GUVERNATORËVE

**REZOLUTA NR. 663
RRITJA E PËRGJITHSHME E KAPITALIT E VITIT 2018**

Duke pasur parasysh se drejtorët ekzekutivë, duke shqyrtuar çështjen e zgjerimit të burimeve të Bankës nëpërmjet rritjes së kapitalit të saj të autorizuar, kanë arritur në përfundimin se një rritje e tillë do të ishte e dëshirueshme dhe në raportin e tyre të miratuar më 4 qershor 2018, kanë paraqitur një propozim për një rritje të tillë në Bordin e Guvernatorëve;

Duke pasur parasysh se drejtorët ekzekutivë kanë propozuar që secili anëtar të autorizohet, në bazë të kushteve të caktuara, të nënshkruajë aksionet e kapitalit të ri të autorizuar në raport me numrin total të aksioneve që anëtari ka nënshkruar dhe është i autorizuar të nënshkruajë, duke përfshirë edhe aksionet

e anëtarëve të caktuar që do të autorizohen të nënshkruajnë në përputhje me rezolutën e propozuar me titull “Rritja e kapitalit selektiv 2018” (në vijim e referuar si “Rezoluta e rritjes së kapitalit selektiv”);

Tashmë, si rrjedhojë, Bordi i Guvernatorëve me anë të kësaj rezolute vendos si më poshtë:

1. Fondi i kapitalit të autorizuar i Bankës do të rritet me 230,500 aksione të fondit të kapitalit, secila prej të cilave ka një vlerë nominale prej 100,000\$ në lidhje me dollarët e Shteteve të Bashkuara të peshës dhe cilësisë në fuqi më 1 korrik 1944, siç interpretohet nga drejtorët ekzekutivë, që rezulton në një vlerë nominale të barabartë me njëqind e njëzetmijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë dollarë amerikanë (120,635 \$).

2. Çdo anëtar i Bankës është i autorizuar të regjistrojë deri në numrin total të aksioneve të vendosura përbri emrit të tij në tabelën e mëposhtme, në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 3 më poshtë:

Anëtari	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS GCI-së	Anëtari	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS GCI-së
Afganistan	55	El Salvador	46
Shqipëri	113	Guinea Ekuatoriale	71
Algjeri	1,136	Eritrea	60
Angola	369	Estoni	113
Antigua dhe Barbuda	60	Etiopi	152
Argjentinë	2,540	Fixhi	118
Armeni	166	Finlandë	1,141
Australi	3,243	Francë	9,022
Austri	1,507	Gabon	95
Azerbajxhan	240	Gambia	78
Bahamas,	127	Gjeorgji	214
Bahreini	136	Gjermani	9,849
Bangladesh	655	Gana	224
Barbados	88	Greqi	371
Bjellorusi	406	Grenada	62
Belgjikë	3,596	Guatemalë	203
Belize	53	Guinea	189
Benin	127	Guinea-Bisao	62
Butan	69	Guajana	143
Bolivi	260	Haiti	157
Bosnjë - Hercegovinë	81	Honduras	65
Botsvana	76	Hungari	1,035
Brazil	5,410	Islandë	164
Brunei Darusalam	224	Indi	7,074
Bullgari	632	Indonezi	2,397
Burkina Faso	127	Republika Islamike e Iranit	3,358
Burundi	106	Irak	422
Kepi i gjelbër	74	Irlandë	781
Kamboxia	51	Israeli	613
Kamerun	224	Itali	6,325
Kanada	5,852	Xhamajkë	311
Republika e Afrikës Qendrore	99	Japoni	16,603
Çad	99	Jordani	194
Kili	980	Kazakistan	477
Kinë	13,860	Kenia	348
Kolumbi	980	Kiribati	69
Komoros	37	Republika e Koresë	3,762
Republika Demokratike e Kongos	346	Kosovë	127
Republika e Kongos	106	Kuajt	1,865
Kosta Rika	115	Republika e Kirgistanit	113
Bregu i Fildishtë	355	Republika Popullore Demokratike e	
Kroaci	281	Laosit	30
Qipro	175	Letoni	168
Republika Çeke	786	Liban	111
Danimarkë	1,749	Lezoto	97
Xhibut	81	Liberi	62
Domenika	58	Libi	952
Republika Domenikane	260	Lituani	187
Ekuador	376	Luksemburg	233
Republika Arabe e Egjiptit	1,079	Ish Republika Jugosllave e	
		Maqedonisë	53
		Madagaskar	207

Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë
Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service

Anëtar	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS GCI-së	Anëtar	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA SIPAS GCI-së
Malavi	159	Ishujt Solomon	74
Malajzi	1,051	Somali	65
Maldivë	44	Afrika e Jugut	1,726
Mali	168	Sudani i Jugut	145
Maltë	127	Spanjë	4,393
Ishujt Marshall	41	Sri Lanka	521
Mauritani	131	Shën Kitts dhe Nevis	25
Mauritius	148	Shën Lucia	65
Meksikë	3,965	Shën Vincent and dhe Grenadine	32
Shtetet e Federuara të Mikronezisë	48	Sudan	168
Moldavi	201	Suriname	39
Mongoli	69	Svazilend	51
Mali i Zi	81	Suedi	2,088
Marok	671	Zvicër	3,395
Mozambik	136	Republika Arabe e Sirisë	249
Mianmar	350	Taxhikistan	122
Namibi	182	Tanzani	134
Nauru	53	Tajlandë	1,143
Nepal	143	Timor-Leste	76
Hollandë	4,495	Togo	161
Zelandë e Re	936	Tonga	71
Nikaragua	88	Trinidad dhe Tobago	320
Niger	99	Tunizi	171
Nigeri	1,614	Turqi	2,547
Norvegji	1,390	Turkmenistan	69
Oman	205	Tuvalu	41
Pakistan	1,176	Uganda	95
Palau	2	Ukrainë	1,335
Panama	95	Emiratet e Bashkuara Arabe	585
Papua Guinea e Re	189	Mbretëri e Bashkuar	9,022
Paragvaj	168	Shtetet e Bashkuara	38,662
Peru	756	Urugvaj	339
Filipine	987	Uzbekistan	353
Poloni	1,701	Vanuatu	78
Portugali	742	Republika Bolivariane e Venezuelës	1,955
Katar	231	Vietnam	440
Rumani	682	Republika e Jemenit	224
Federata Ruse	6,572	Zambia	392
Ruandë	152	Zimbabve	362
Samoa	78		
San Marino	55		
Sao Tome dhe Principe	71		
Arabia Saudite	6,392		
Senegal	297		
Serbi	343		
Sejshellet	25		
Sierra Leone	106		
Singapor	590		
Republika Sllovaqe	396		
Slloveni	168		
		Numri total i aksioneve	230,500

Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë
Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service

3. Çdo regjistrim/nënshkrim i autorizuar sipas paragrafit 2 më sipër do të jetë në afatet dhe kushtet e mëposhtme:

a) çmimi i regjistrimit/nënshkrimit do të jetë nominal;

b) secili anëtar mund të regjistrojë/nënshkruajë deri në numrin total të aksioneve të vendosura përbri emrit të tij në tabelën në paragrafin 2 më lart herë pas here përpara përvjetorit të pestë (5-të) të datës kur kjo rezolutë është miratuar; me kusht që me kërkesën e një anëtar:

i. Presidenti mund të zgjasë periudhën e nënshkrimit/regjistrimit deri në përvjetorin e gjashtë (6-të) të datës në të cilën është miratuar kjo rezolutë, në bazë të kushteve që mund të kërkojnë nga Presidenti në lidhje me zgjatjen e tillë dhe

ii. drejtorët ekzekutivë mund të zgjasin periudhën e nënshkrimit/regjistrimit deri në përvjetorin e shtatë (7-të) të datës në të cilën është miratuar kjo rezolutë, në bazë të kushteve që mund të kërkojnë nga drejtorët ekzekutivë në lidhje me zgjatjen e tillë;

c) anëtar i nënshkrues i paguan Bankës në bazë të nenit II, seksioni 7 (i) të aktit themelues të Bankës (në vijim të referuara si “nenet”):

i. ar ose dollarë amerikanë të barabartë me 2.0% (dy për qind) të çmimit të regjistrimit/nënshkrimit të aksioneve të nënshkruara; dhe

ii. një shumë në monedhën e vet ose në ndonjë monedhë tjetër të barabartë me 18.0% (tetëmbëdhjetë për qind) të çmimit të këtij regjistrimi/nënshkrimit,

me kusht që në çdo rast monedha e tillë: (A) paguhet në para të gatshme ose në përputhje me paragrafin (d) më poshtë, dhe (B) është lirisht e konvertueshme për përdorim në veprimet e Bankës;

d) pagesat e shumave sipas paragrafit (c) më lart mund të kryhen me anë të depozitimit të notave/dëftesave të kërkesave pa interes, në një formë të pranueshme për Bankën që Banka do të arkëtojë menjëherë, me kusht që nëse nota/dëftesa kuotohet/caktohet në një monedhë të ndryshme nga dollarët e Shteteve të Bashkuara dhe nëse shuma e notave/dëftesave është më e ulët sesa shuma e kërkueshme në dollarë të Shteteve të Bashkuara në datën arkëtimit, anëtari do të kryejë një pagesë shtesë për Bankën brenda një periudhe prej njëzet ditësh nga paraqitja e notës/dëftesës për arkëtim, për të garantuar që Banka të marrë çmimin e plotë të blerjes së aksioneve të nënshkruara/të regjistruara;

e) para se ndonjë nënshkrim/regjistrim të pranohet nga Banka, anëtari do të ketë:

i. marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar një nënshkrim/regjistrim të tillë dhe dhënë Bankës informacion të tillë për të, siç mund ta kërkojë Banka;

ii. kryer pagesat e parashikuara në paragrafin 3(c) dhe (d) më lart; dhe

iii. marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar përdorueshmërinë e pakufizuar dhe të menjëhershme nga Banka, në veprimet e saj, të pjesës së çmimit të nënshkrimit/regjistrimit të aksioneve të paguara në monedhën e anëtarit sipas nenit II, seksioni 7(i) i neneve;

f) duke nënshkruar/regjistruar këto aksione, anëtari konsiderohet:

i. të ketë dhënë pëlqimin e tij të përvokueshëm për përdorimin e pakufizuar dhe të menjëhershëm të kapitalit të tij të paguar, pavarësisht të drejtave të anëtarit për miratim sipas nenit IV, seksioneve 2(a) dhe (b) të neneve, të drejtës së tij sipas nenit V, seksionit 12 të neneve për të zëvendësuar notat/dëftesat ose detyrimet e ngjashme ose të drejta ose kufizime të tjera; dhe

ii. konfirmoi se pjesa e paguar e nënshkrimit/regjistrimit të tij është e nevojshme në veprimet e Bankës dhe se nota/dëftesa ose detyrime të ngjashme nuk mund të zëvendësohen në vend të monedhës/valutës së ndonjë anëtar; dhe

g) në rast se rezoluta e rritjes së kapitalit selektiv nuk është miratuar në ose para datës së miratimit të kësaj Rezolute, atëherë asnjë nënshkrim/regjistrim nuk do të miratohet nga Banka para jo më herët se:

i. data kur Bordi i Guvernatorëve miraton rezolutën për rritjen e kapitalit selektiv; dhe

ii. data kur Banka njofton secilin anëtar se periudha e votimit për rezolutën e rritjes së kapitalit selektiv, siç mund të zgjatet, është mbyllur. Nëse periudha e votimit për rezolutën për rritjen e kapitalit selektiv mbyllet pa miratimin e rezolutës për rritjen e kapitalit selektiv nga Bordi i Guvernatorëve, numri i aksioneve të autorizuar për t'u nënshkruar nga secili anëtar sipas paragrafit 2 më sipër duhet të përshtatet në mënyrë që alokimi proporcional i aksioneve të secilit anëtar pas dhënies fuqi të rritjes së fondit të kapitalit sipas kësaj rezolute, do të jetë i barabartë me alokimin proporcional të aksioneve të anëtarit, pa i dhënë fuqi rezolutës për rritjen e kapitalit selektiv.

4. Të gjitha të drejtat, duke përfshirë të drejtën e votës, të fituara në lidhje me aksionet për të cilat kryhet pagesa me notë/dëftesë sipas paragrafit 3 (d) më lart, pezullohen:

a) nëse pagesa nuk është kryer brenda një periudhe prej njëzet ditësh nga paraqitja e saj për arkëtim; ose

b) nëse, për çdo notë/dëftesë që është në një monedhë të ndryshme nga dollari amerikan, arkëtimi konstaton një mangësi në çmimin e blerjes së aksioneve dhe pagesa shtesë nuk kryhet brenda një periudhe prej njëzet ditësh nga data e pagesës përkatëse,

në secilin rast, vetëm në lidhje me aksionet për të cilat pagesa nuk është marrë dhe derisa pagesa e plotë në para të gatshme të merret nga Banka.

5. Çdo aksion i fondit të kapitalit të Bankës që mbetet i panënshkruar/i paregjistruar ose i papaguar në fund të periudhës së nënshkrimit/regjistrimit të përcaktuar në paragrafin 3 (b) më sipër, duke përfshirë aksionet në lidhje me të cilin janë pezulluar të drejtat e votimit për shkak të mospagesës siç përshkruhet në paragrafin 5 më sipër, do të bëhet pjesë e fondit të kapitalit të paalokuar të Bankës.

6. Banka miraton një kuadër të qëndrueshmërisë financiare në përputhje me objektivat dhe parimet e përshkruara në raportin "Financimi i qëndrueshëm për zhvillimin e qëndrueshëm: propozimi i paketës së kapitalit të grupit të bankës botërore "(DC2018-0002) për takimin e 21 prillit 2018 të Komitetit të Përbashkët Ministror të Bordeve të Guvernatorëve të Bankës dhe Fondit për Transferimin e Burimeve Reale në Vendet në Zhvillim, me rishikim pesë vjeçar të zbatimit të kuadrit dhe përafrimin e tij me strategjinë e Bankës.

(Miratuar më datë 1 tetor 2018)



BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

BORDI I GUVERNATORËVE

REZOLUTA NR. 664

RRITJA E KAPITALIT SELEKTIV E VITIT 2018

Duke pasur parasysh se, me rezolutën nr. 612, të miratuar më 16 mars 2011, Bordi i Guvernatorëve ka vendosur se mbajtja e aksioneve të Bankës duhet të rishikohet çdo pesë vjet, duke filluar në vitin 2015 dhe më pas rishikimi tjetër i rregullt i mbajtjes së aksioneve do të fillojë në vitin 2020;

Duke pasur parasysh se, në lidhje me rishikimin e mbajtjes së aksioneve në vitin 2015, drejtorët ekzekutivë kanë arritur në përfundimin se rritja e fondit të kapitalit të autorizuar të Bankës dhe alokimi selektiv i aksioneve tek anëtarët, siç përcaktohet në paragrafin 2 të kësaj rezolute, do të ishte e dëshirueshme dhe, në raportin e tyre të miratuar më 4 qershor 2018, i kanë paraqitur një propozim Bordit të Guvernatorëve për një rritje të tillë; dhe

Duke pasur parasysh se, për të arritur qëllimin e rritjeve të veçanta në nënshkrimin/regjistrimin e anëtarëve, drejtorët ekzekutivë kanë vënë re se është e nevojshme që të gjithë anëtarët të heqin dorë nga të drejtat e tyre sipas nenit II, seksioni 3(c) i aktit themelues të Bankës (në vijim referuar si “nenet”) për t’u regjistruar në një pjesë proporcionale të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar sipas kësaj rezolute.

Tashmë, si rrjedhojë, Bordi i Guvernatorëve me anë të kësaj rezolute vendos si më poshtë:

1. Fondi i kapitalit të autorizuar i Bankës do të rritet me 245,773 aksione të fondit të kapitalit, ku secili ka një vlerë nominale prej 100,000\$ në lidhje me dollarët e Shteteve të Bashkuara të peshës dhe cilësisë në fuqi më 1 korrik 1944, siç interpretohet nga drejtorët ekzekutivë, që rezulton në një vlerë nominale të barabartë me njëqind e njëzet mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë dollarë amerikanë (120,635 \$).

2. Çdo anëtar i Bankës është i autorizuar të regjistrojë deri në numrin total të aksioneve të vendosura përbri emrit të tij në tabelën e mëposhtme, në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 3 më poshtë:

Anëtarë	Numri i aksioneve të alokuara sipas SCl-së	Anëtarë	Numri i aksioneve të alokuara sipas SCl-së
Afganistan	93	El Salvador	176
Shqipëri	55	Guinea Ekuatoriale	74
Algjeri	829	Eritrea	70
Angola	352	Estoni	89
Antigua dhe Barbuda	5	Etiopia	207
Argjentinë	1,644	Fikhi	38
Armeni	194	Finlandë	1,146
Australi	4,219	Francë	9,185
Austri	2,025	Gabon	63
Azerbajxhan	265	Gambia	92
Bahamas	45	Gjeorgji	101
Bahrein	114	Gjermani	12,155
Bangladesh	761	Ganë	259
Barbados	19	Greqi	684
Bjellorusi	267	Grenada	4
Belgjikë	2,272	Guatemalë	236
Belizë	7	Guinea	220
Benin	149	Guinea-Bisao	72
Butan	80	Guaiana	55
Bolivi	302	Haiti	183
Bosnje-Hercegovinë	72	Honduras	76
Botsvana	61	Hungari	628
Brazil	6,203	Islandë	69
Brunei Darussalam	107	Indi	8,178
Bullgari	369	Indonezi	3,435
Burkina Faso	149	Republika Islamike e Iranit	2,121
Burundi	123	Irak	788
Çepi i Gjellbër	86	Irlandë	847
Kamboxhia	75	Izrael	754
Kamerun	259	Itali	6,447
Kanada	6,249	Xhamajkë	163
Republika e Afrikës Qendrore	115	Japoni	17,838
Çad	115	Jordani	134
Kili	794	Kazakistan	705
Kinë	46,405	Kenia	404
Kolumbi	1,096	Kiribati	80
Komoros	44	Republika e Koresë	3,999
Republika Demokratike e Kongos	402	Kosovë	149
Republika e Kongos	124	Kuvajti	1,161
Kosta Rika	154	Republika e Kirgistanit	131
Bregu i Fildishtë	413	Republika Popullore Demokratike e Laosit	53
Kroaci	189	Letoni	105
Qipro	85	Liban	154
Republika Çeke	672	Lezoto	112
Danimarkë	1,516	Liberi	72
Xhibut	95	Libi	575
Domenika	2	Lituani	161
Republika Domenikane	231	Luksemburg	284
Ekuador	319	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	47
Republika Arabe e Egjiptit	1,238	Madagaskar	242

Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë
Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service

Anëtar	Numri i aksioneve të alokuara sipas SCI-së	Anëtar	Numri i aksioneve të alokuara sipas SCI-së
Malavi	186	Ishujt Solomon	86
Malajzi	1,154	Somali	75
Maldivë	12	Afrikkë e Jugut	1,236
Mali	197	Sudani i Jugut	169
Maltë	45	Spanjë	4,343
Ishujt Marshall	1	Sri Lanka	607
Mauritani	154	Shën Kitts dhe Nevis	3
Mauritius	58	Shën Luçia	5
Meksikë	3,636	Shën Vincent dhe Grenadines	3
Shtetet e Federuara të Mikronezisë	57	Sudan	283
Moldavi	234	Suriname	19
Mongoli	80	Svazilend	59
Mali i Zi	18	Suedi	3,227
Marok	779	Zvicër	2,834
Mozambik	157	Republika Arabe e Sirisë	289
Mianmar	408	Taxhikistan	142
Namibi	80	Tanzani	186
Nauru	0	Tajlandë	1,501
Nepal	166	Timor-Leste	89
Hollandë	3,787	Togo	188
Zelandë e Re	564	Tonga	83
Nikaragua	103	Trinidad dhe Tobago	169
Niger	115	Tunizi	200
Nigeri	1,616	Turqi	2,478
Norvegji	1,938	Turkmenistan	138
Oman	278	Tuvalu	0
Pakistan	1,138	Ugandë	110
Palau	1	Ukrainë	820
Panama	152	Emiratet e Bashkuara Arabe	1,116
Papua Guinea e Re	220	Mbretëri e Bashkuar	9,185
Paraguaj	103	Shtetet e Bashkuara	42,298
Peru	645	Uruguaj	181
Filipine	997	Uzbekistani	409
Poloni	1,644	Vanuatu	90
Portugali	684	Republika Bolivariane e Venezuelës	1,219
Katar	1,161	Vietnam	698
Rumani	662	Republika e Jemenit	261
Federata Ruse	6,044	Zambia	457
Ruanda	177	Zimbabve	421
Samoa	92		
San Marino	7	Numri total i aksioneve	267,943
Sao Tome dhe Principe	83		
Arabi Saudite	4,070		
Senegal	346		
Serbi	184		
Sejshellet	6		
Sierra Leone	123		
Singapor	950		
Republika Sllovake	314		
Slloveni	160		

Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë
Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service

3. Çdo nënshkrim i autorizuar sipas paragrafit 2 më sipër do të jetë në afatet dhe kushtet e mëposhtme:

a) çmimi i regjistrimit/nënshkrimit do të jetë nominal;

b) secili anëtar mund të nënshkruajë deri në numrin total të aksioneve të vendosura përbri emrit të tij në tabelën në paragrafin 2 më lart herë pas here përpara përvjetorit të pestë (5-të) të datës kur kjo rezolutë është miratuar; me kusht që me kërkesën e një anëtar; i) Presidenti mund të zgjasë periudhën e nënshkrimit/regjistrimit deri në përvjetorin e gjashtë (6-të) të datës në të cilën është miratuar kjo rezolutë, në bazë të kushteve që mund të kërkojnë nga Presidenti në lidhje me zgjatjen e tillë; dhe ii) drejtorët ekzekutivë mund të zgjasin periudhën e nënshkrimit/regjistrimit deri në përvjetorin e shtatë (7-të) të datës në të cilën është miratuar kjo rezolutë, në bazë të kushteve që mund të kërkojnë nga drejtorët ekzekutivë në lidhje me zgjatjen e tillë;

c) anëtar i nënshkruar i paguan Bankës në bazë të nenit II, seksioni 7 (i) i aktit themelues të Bankës (në vijim referuar si “nenet”):

i) ar ose dollarë amerikanë të barabartë me 0.6% (zero pikë gjashtë për qind) të çmimit të regjistrimit/nënshkrimit të aksioneve të nënshkruara; dhe

j) një shumë në monedhën e vet ose në ndonjë monedhë tjetër të barabartë me 5.4% (pesë pikë katër për qind) të çmimit të këtij regjistrimi/nënshkrimi,

me kusht që në çdo rast monedha e tillë: A) paguhet në para të gatshme ose në përputhje me paragrafin (d) më poshtë; dhe B) është lirisht e konvertueshme për përdorim në veprimet e Bankës;

d) pagesat e shumave sipas paragrafit 3 (c) më lart mund të kryhen me anë të depozitimit të notave/dëftesave të kërkesave pa interes, në një formë të pranueshme për Bankën që Banka do të arkëtojë menjëherë, me kusht që nëse nota/dëftesa kuotohet/caktohet në një monedhë të ndryshme nga dollarët e Shteteve të Bashkuara dhe nëse shuma e notave/dëftesave është më e ulët sesa shuma e kërkuar në dollarë të Shteteve të Bashkuara në datën arkëtimit, anëtarin do të kryejë një pagesë shtesë për Bankën brenda një periudhe prej njëzet ditësh nga paraqitja e notës/dëftesës për arkëtim, për të garantuar që Banka të marrë çmimin e plotë të blerjes së aksioneve të nënshkruara/të regjistruara;

e) Banka do të kërkojë pjesët 2% dhe 18% të nënshkrimeve/regjistrimeve të pagueshme sipas nenit II, seksioni 7 (i) i neneve, që nuk janë të nevojshme të paguheshin sipas paragrafit 3 (c) sa më lart, vetëm nëse është e nevojshme për të përmbushur detyrimet e Bankës për fonde të marra hua apo për kredi të garantuara nga ajo dhe jo për përdorim nga Banka në aktivitetet e saj kredituese apo për shpenzime administrative;

f) para se ndonjë nënshkrim/regjistrim të pranohet nga Banka, anëtarin do të ketë:

i. marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar një nënshkrim/regjistrim të tillë dhe dhënë Bankës informacion të tillë për të, siç mund ta kërkojë Banka;

ii. kryer pagesat e parashikuara në paragrafin 3(c) dhe (d) më lart; dhe

iii. marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar përdorueshmërinë e pakufizuar dhe të menjëhershme nga Banka, në veprimet e saj, të pjesës së çmimit të nënshkrimit/regjistrimit të aksioneve të paguara në monedhën e anëtarit sipas nenit II, seksioni 7(i) i neneve;

g) duke nënshkruar/regjistruar këto aksione, anëtarin konsiderohet:

i. të ketë dhënë pëlqimin e tij të parevokueshëm për përdorimin e pakufizuar dhe të menjëhershëm të kapitalit të tij të paguar, pavarësisht të drejtave të anëtarit për miratim sipas nenit IV, seksioneve 2(a) dhe (b) të neneve, të drejtës së tij sipas nenit V, seksionit 12 të neneve për të zëvendësuar notat/dëftesat ose detyrimet e ngjashme ose të drejta ose kufizime të tjera; dhe

ii. konfirmoi se pjesa e paguar e nënshkrimit/regjistrimit të tij është e nevojshme në veprimet e Bankës dhe se nota/dëftesa ose detyrime të ngjashme nuk mund të zëvendësohen në vend të monedhës/valutës së ndonjë anëtarin; dhe

4. Në rast se Bankës nuk i dërgohet një njoftim nga ndonjë anëtar brenda 21 (njëzet e një) ditë nga data e dërgimit të kësaj rezolute tek guvernatorët për votimin që synon të ushtrojë të drejtat e tij sipas nenit II, seksioni 3 (c) i neneve për të nënshkruar/regjistruar aksionin/pjesën e tij proporcionale të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të parashikuar sipas kësaj rezolute, një anëtar i tillë do të konsiderohet se ka hequr dorë nga një e drejtë e tillë.

5. Të gjitha të drejtat, duke përfshirë të drejtën e votës, të fituara në lidhje me aksionet për të cilat kryhet pagesa me notë/dëftesë sipas paragrafit 3 (d) më lart, pezullohen:

a) nëse pagesa nuk është kryer brenda një periudhe prej njëzet ditësh nga paraqitja e saj për arkëtim; ose

b) nëse, për çdo notë/dëftesë që është në një monedhë të ndryshme nga dollari amerikan, arkëtimi konstaton një mangësi në çmimin e blerjes së aksioneve dhe pagesa shtesë nuk kryhet brenda një periudhe prej njëzet ditësh nga data e pagesës përkatëse,

në secilin rast, vetëm në lidhje me aksionet për të cilat pagesa nuk është marrë dhe derisa pagesa e plotë në para të gatshme të merret nga Banka.

6. Çdo aksion i fondit të kapitalit të Bankës që mbetet i panënshkruar/i paregjistruar ose i papaguar në fund të periudhës së nënshkrimit/regjistrimit të përcaktuar në paragrafin 3 (b) më sipër, duke përfshirë aksionet në lidhje me të cilin janë pezulluar të drejtat e votimit për shkak të mospagesës siç përshkruhet në paragrafin 5 më sipër, do të bëhet pjesë e fondit të kapitalit të paalokuar të Bankës.

7. Kjo rezolutë nuk hyn në fuqi në rast se të gjithë anëtarët nuk kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre sipas nenit II, seksioni 3 (c) të neneve për të nënshkruar/regjistruar aksionin/pjesën e tyre proporcionale të rritjes së fondit të kapitalit të autorizuar të Bankës të parashikuar sipas kësaj rezolute.

(Miratuar më datë 1 tetor 2018)